

V E N D I M
Nr. 382, datë 31.5.2001

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË
CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I SISTEMIT RRUGOR SUKTH –DURRËS, NË
TERRITORIN E QARKUT TË DURRËSIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në zbatim të pikës 1 të nenit 5 të neneve 20 dhe 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik“, me propozimin e Ministrit të Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Sukth – Durrës në territorin e qarkut të Durrësit.
 2. Shpronësimi bëhet në favor të Ministrisë së Transportit.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen të konpensohen në vlerë të plotë sipas masës së kompensimit përkatës që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, me sipërfaqe të përgjithshme 378 m2 tokë /arë, 187 m2 objekte ndërtimi, vlerësuar me shumën e përgjithshme prej 5 082 100 (pesë milionë e tetëdhjetë mijë e njëqind) lekësh.
 4. Ky fond, sipas pikës 3 të këtij vendimi, të përballohet nga buxheti i vitit 2001, në zërin “Shpronësime”, miratuar për Ministrinë e Transportit.
 5. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 30.6.2001.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

Fshati Shenavlash

Lista e pronarëve që shpronësohen për efekt të superstradës Vorë-Durrës, seksioni Sukth – Durrës

Lloji i pasurisë: tokë bujqësore (nr.1-2)

Nr.	Emër Atësia Mbiemër	Nr.i pasurisë	Sip. m2	Vlera në m2	Vlera totale në lekë
1	Bajram Nustret Sadiku	284/49	108	1200	129600
2	Isak Rasim Brahaj	290/36	63	1200	75600
3	Muharrem Rustem Hoxha		207	1200	284400
	Shuma:				

Mbyllet me numër rendor 3 (tre)

Lloji i pasurisë: ndërtesë (nr.1-2)

Nr	Emër Atësia Mbiemër	Nr.i pasurisë	Sip. m2	Vlera në m2	Vlera totale në lekë
1	Bajram Nustret Sadiku	284/49	46	23.500	1016140
2	Qemal Shaqir Loga	290/72	141	23.500	3048400
	Shuma:				

Mbyllet me numër rendor 2 (dy)

Shpenzimet e procedurës së shpronësimit (Publikime) për të gjithë këtë segment rrugor nga Sukthi në Durrës kapin vlerën prej 563500 lekë.

